



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za žalbe i Predstavke

ZL.Anr.1106/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Hasan Shala kryesues, Fejzullah Rexhepi dhe Adnan Konushevci anëtar, me pjesëmarrjen e Zyrtares së Lartë Ligjore Antigona Murati, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, dega në Rahovec paraqitur kundër subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), me seli në Prishtinë, dega në Rahovec, për shkak të parregullësive gjatë numërimit të votave, në raundin e dytë të Zgjedhjeve Lokale të mbajtura më 19.11.2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 21.11.2017, mori këtë:

V E N D I M

I. Pranohet pjesërisht si e bazuar ankesa subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, dega në Rahovec, ZL.Anr. 1106/2017 të datës 20.11.2017, me të cilën ka kërkuar që të rinumërohen të gjitha fletëvotimet në Vendvotimet 1624A/01R, 1624A/02R, 1624A/03D

II. Urdhërohet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), që të rinumëroj të gjitha fletëvotimet e kandidatëve për kryetar të Komunës së Rahovecit si në pjesën e I (parë) të dispozitivit të këtij vendimi.

III. Rezultati i cili del pas rinumërimit të fletëvotimeve në Vendvotimet si në pjesën -I- të këtij dispozitivi, duhet të përfshihen me rastin e shpalljes në rezultatin përfundimtar.

IV. Refuzohet si e pa bazuar ankesa e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, dega në Rahovec, në pjesën që kërkohet përsëritja e votimit në Qendrën e Votimit 1626A në shkollën fillore “Isa Boletini”, 1612A, 1602x/01R në Rahovec, lidhur me e blerjes dhe manipulimeve të votës.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar ankesën ZL.Anr.1106/2017 me datë 20.11.2017 nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), ku ka pretenduar se në Qendrën e Votimit 1624 A, vendvotimi 1624A/01R në shkollën fillore “ Liria” Bellacërkë, në FPR-në për Kryetar Komune, për kandidatin e PDK-së Idriz Vehapi , në vend të votave të sakta 150 sa ndodhen në kutinë e votimit të mbyllur sipas normave, janë shënuar në FPR 105 vota e që është mungesë prej 45 votave. Parashtruesi i ankesës në vazhdim pretendon se në qendrën e votimit 1626A në shkollën fillore “Isa Boletini” në Rahovec, veprimtarë të identifikuar të subjektit politik AAK, në distancë prej 20 m nga Qendra e Votimit, kanë blerë vota në mënyrë të hapur dhe publike në favor të kandidatit të AAK-së Smajl Latifi, duke e dëmtuar thelbësisht

me vota PDK-në, dega në Rahovec. Po ashtu me të njëjtën datë ka paraqitur plotësimin e të njëjtës ankesë në të cilën pretendon se pas dorëzimit të ankesës së PDK-së në Rahovec, për shkeljet e faktura dhe të evidentuara nga AAK, dega në Rahovec për blerjen e votave dhe manipulimin e rezultatit në Qendrat e Votimit 1612A dhe 1626A, si dhe për shkak të lëshimeve thelbësore procedurale dhe teknike në dëm të kandidatit të PDK-së Idriz Vehapi, në Qendrën e Votimit 1602X dhe 1602X/01R në shkollën e mesme profesionale “Selajdin Mullaabazi-Mici” në Rahovec, duke u nënshkruar në Librin e Votimit dhe duke mbushur kutitë me vota. Më tej ka theksuar se dyshojnë se personat të cilët nuk kanë dalur të votojnë në vendvotimin e cekur, kanë nënshkruar personeli nga Komisioni Zgjedhor dhe paralel me të i kanë plotësuar fletëvotimet për personat e munguar në dobi të kandidatit të AAK-së Smajl Latifi. Andaj ka kërkuar që të bëhet rinumërimi në vendvotimet e cekura më lartë.

Në mbështetje të pretendimeve ankimore ka bashkangjitur fotot e bëra në vendin e ngjarjes, si dhe rasti i hapur me Kallëzim Penal nga Stacioni i Policisë në Rahovec, pranë Prokurorisë Themelore, dega në Gjakovë, te prokurori kujdestar më 19.11.2017, Raporti me shkrim i koordinatores së KDI për Komunën e Rahovecit Vjollca Selimi-Gurgule, i dërguar në Call Center në Prishtinë dhe kompetentëve në “EU”.

Në përgjigje në ankesë të datës 21.11.2017, subjekti politik AAK thekson se fotot e vendit të ngjarjes kinse të aktivistëve të AAK-së në Rahovec dike blerë vota është trillim dhe shpifje nga ana e subjektit politik PDK-së pasi që në fotografit e bashkangjitura në ankesë nuk shihet asnjë indicje më e vogël që të vërtetohet se cilit subjekt politik i takojnë dhe janë njerëz të fotografuar kot dhe janë totalisht të pafajshëm. Në vazhdim të përgjigjes AAK deklaroi se procesi zgjedhor në Rahovec respektivisht në shkollën “LIRIA” në fshatin Bellacerk dhe në shkollën fillore “Isa Boletini” në Rahovec është i mbajtur i rregullt dhe të gjithë personat kompetent për mbarëvajtjen e zgjedhjeve në këto dy shkolla i kanë nënshkruar procesverbalet. Më tej ka kërkuar që ankesa e ankuesit të Refuzohet si e pabazuar.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 par. 2 të LZP-së, gjeti se:

Ankesa është pjesërisht e bazuar

Paneli gjeti se pretendimet ankimore të ankuesit janë të bazuara, për faktin se pas shqyrtimit të provave dhe shkresave të lëndës si dhe dëshmimeve të ofruara nga ankuesi që gjenden në shkresat e lëndës dhe nga hetimi i bërë në materialin zgjedhor ka konstatuar se ka mospërputhje të rezultateve të shpallura nga vendimi i KQZ-së për vendvotimet e lartcekura si më lart, andaj mbi këtë bazë dhe në mbështetje të nenit 117.4 të LZP-së, PZAP-i urdhëron KQZ-në që të bëhet rinumërimi i të gjitha fletëvotimeve për kandidatët për kryetar të komunës së Rahovecit për vendvotimet e lartcekura, ashtu që rezultati i dal nga ky rinumërim të bashkëngjitet rezultatit përfundimtar.

Vendimi i PZAP-it ka mbështetje të nenit 106 par.2 të LZP-së, ku përcaktohet: “*Para certifikimit të rezultatit të zgjedhjeve, KQZ-ja mund të urdhërojë rinumërimin e votave*”

në cilindo vendvotim, qendër të numërimit ose edhe përsëritjen e votimit në një qendër votimi apo në një komunë”

PZAP-i, më qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura vendimin e ka bazuar në nenin 119.5 të LZP-së, ku parashihet se, *PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është rreptësisht e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze* po ashtu lidhur me nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Rezultati që del nga rinumërimet e bëra si në pjesën e I të dispozitivit, të këtij vendimi, duhet të përfshihet në rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve.

Sa i përket pjesës refuzuese si në pikën IV të këtij vendimi, Paneli pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me blerjen e votave dhe manipulimeve të rezultatit të votimit në qendrën e votimit 1612A,1626 A 1602x/01R si dhe manipulimet e votave gjeti se parashtruesi në ankesë me asnjë provë bindëse nuk i ka argumentuar me prova pretendimet e tij ne ankesë . Prandaj, Paneli ankesën e konsideron si të përgjithësuar dhe të pa argumentuar me fakte dhe si të tillë jo bindës pasi që nuk i plotësoj kërkesat ligjore të përcaktuara me dispozitën e nenit 117 i Ligjit nr. 03/-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë në nenin 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

ZL.Anr.1106/2017 më datën 21.11.2017

Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi Gjykatës Supreme të Kosovës.

Kryesues i Panelit

Hasan Shala

